



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 10388 prot.

Tiranë, më 7.5.2024

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi të brendshëm (me procedurën e lëvizjes paralele brenda sistemit doganor)

Drejtuar: **DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE
DEGËVE DOGANORE**

Për publikim: **DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË KOORDINIMIT DHE MARRËDHËNIEVE ME
JASHTË**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të pikës 5, të nenit 15, të ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuarm, të Kreut II dhe III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 921, datë 29.12.2014 “Për Personelin e Administratës Doganore”, i ndryshuar, shpall konkurimin e brendshëm për pozicionet:

Specialist, Sektori Legjislacionit dhe Përafrimit me BE-në, Drejtoria Juridike, Departamenti Administrativ, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Klasa e pagës C1, Klasa e pagës IV- 1, (1 pozicion pune)

Përshkrim përgjithësues për pozicionin:

Specialisti i Sektorit të Legjislacionit dhe Përafrimi me BE-në, raporton tek Përgjegjesi i Sektorit, i cili vepron si Zyrtar Raportues tek Drejtori i Drejtorisë Juridike, në lidhje me kryerjen e detyrave në mënyrë korrekte, përmirësimin dhe modernizimin e kuadrit ligjor, krijimin e kushteve dhe plotësimin e standarteve për të mundësuar aderimin në Konventa Ndërkombetare, përgatitjen e administratës doganore për hyrjen në BE dhe bashkëpunim me biznesin.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij pozicioni është të ndihmojë Doganën për të përmbushur misionin e saj duke siguruar se e gjithë puna në këtë sektor, të kryhet në mënyrë ligjore, korrekte, efikase, dhe e drejtuar drejt praktikave më të mira të BE-së

Kandidatët që konkurojnë për këtë vend pune duhet të plotësojnë këto kritere:

Kriteret minimale :

- Të ketë një vlerësim pozitiv apo një certifikatë/vërtetim për një kualifikim të posaçëm profesional, që i përshtatet vendit të ri të punës
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi
- Të përmbushë kriteret e veçanta në shpalljen për konkurim
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar

Kriteret e veçanta:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Mastër Profesional” ose diploma të barazvlefshme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë në shkencat Juridike.
- Të ketë mbi 1 vitë eksperiencë punë në Administratën Doganore.

Për të qenë pjesëmarrës në konkurim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda datës _____.2024 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

1. Kërkesë për marrje pjesë në testim
2. Curriculum Vitae
3. Rekomandim nga eprori direkt.

Fusha e Njohurive:

1. Ligji nr102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar:
 2. Ligji nr. 61/2012 datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar:
 3. Ligji nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar.
 4. Ligji nr. 9367, datë, 07.07.2015 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar
 5. Urdhëri nr. 146, datë 07.05.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e Degëve Doganore:
 6. Urdhëri nr. 123, datë 09.11.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhërin nr. 90, datë 18.11.2014 “Për miratimin e Kodit të Etikës në Shërbimin Doganor Shqiptar.
- Procedura e përzgjedhjes do të bëhet në mbështetje të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, levizjen paralele, periudhen e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar.
-

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "www.dap.gov.al".

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Genti Gazheli

